

AKTI THEMELUES

SHOQËRISË TREGTARE PRIVATE "TEKNOTRADE LTD."



Ne mbështetje të Ligjit 7638 dt.19.11.1992, sot në Tiranë, me dt.19.10.1993, ortakët :

1. Gianfranco LIUZZI - biri i Oronzos, lindur në Locorotondo (BARI) me 6.4.1947 me banim në Bari në Via della Repubblica, 73/G me passaport n. 804081,dhe
 2. Angela CAMPANELLA - e bija e Cataldos, lindur në Locorotondo (BARI) me 21.5.1948, banuese në Bari në Via della Repubblica, 71/G, me passaport n. 804082
- me dëshirë dhe vullnet të përbashkët, duke vepruar si themelues të shoqërisë së përbashkët "TEKNOTRADE LTD." (Sh.p.k.), me seli në Rrugën Muhamet Gjollësia - Tiranë, lidhëm këtë akt themelimi.

FORMIMI

Neni 1

Të formojmë shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar me emrin e plotë : Shoqëria Private "TEKNOTRADE LTD." (Sh.p.k.) .

SELIA

Neni 2

Selia e shoqërisë do të ketë vendqendrimin në Tiranë, fillimisht në lokalën e ndodhur në Rrugën Muhamet Gjollësia, që ndodhet në katin e tretë të Shtëpisë Botuese Enciklopedike.

Shoqëria mund të hapë vendqendime të tjera të dyta, operative, filiale, përfaqësi dhe agjenci në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe me miratim të organeve kompetente dhe jashtë saj.

KOHËZGJATJA

Neni 3

Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të veprimtarisë së saj ekonomike mbi 10 vjet.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 4

Objekti themelor i veprimtarisë ekonomike do të jetë :

1. Në fushën e prodhimit dhe tregimit me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm të import eksportit si ushqimore, artikuj industrialë, konfeksione kinkalerira, pajisje elektroshtëpiake dhe elektronike, materiale mjeksore, dentare, filma, kaseta audio, video, materiale ndërtimi, makineri e pajisje të ndryshme të import - eksportit.
2. Në fushën e shtypit dhe të botimeve të ndryshme si dhe të tregimit të tyre.
3. Në fushën e hotelërisë, agjenci turizmi, spëdicion, ndërmjetësi, agjenci doganore etj.
4. Në fushën e transportit të pasagjerëve dhe mallrave brenda dhe jashtë vendit.
5. Në fushën e projektimit, realizimit dhe drejtimit të impianteve radiofonikë e televizivë.
6. Në fushën e ndërtimeve qytetare dhe industriale.
7. Në fushën e operacioneve financiare kombëtare e ndërkombëtare.

Që të gjitha këto aktivitete në mënyrë të detajuar do të saktësohen në Aktin e Rëgjistrimit të Shoqërisë dhe në Statutin e saj.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 5

Kapitali themelor i shoqërisë është 50.000.000 Lireta që përbëhet 60 % nga Gianfranco LIUZZI dhe 40 % nga Angela CAMPANELLA.



ORGANET DREJTUESE

Neni 6

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë :

- 1 - Asambleja e ortakëve,
- 2 - Presidenti administrator i shoqërisë.

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e punës së organeve drejtuese do të rregullohet me statut.

MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 7

Shoqëria do të ketë të drejtë të punësojë edhe persona të tretë në të.

BILANCI DHE TË ARDHURAT

Neni 8

Veprimet ekonomike dhe financiare të shoqërisë do të mbyllet me 31 dhjetor të çdo viti, përveç urdhërave të veçanta të Asamblesë.

SHPËRBËRJA E SHOQËRISË

Neni 9

Shpërbërja e shoqërisë do të bëhet sipas rasteve që do të përcaktohen në Statutin e saj.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 10

President i shoqërisë caktohet Gianfranco LIUZZI. Të drejtën e nënshkrimit në emër të shoqërisë "TEKNOTRADE LTD" (Sh.p.k.) e ka vetëm Presidenti i saj dhe të gjithë personat e autorizuar prej tij me autorizim të posaçëm.

Neni 11

Ky akt themelues u përpilua në disa kopje për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë tregtare private "TEKNOTRADE LTD." (Sh.p.k.).

Ortakët :

1. Gianfranco LIUZZI

2. Angela CAMPANELLA

Gianfranco Liuzzi
Angela Campanella

Tiranë, më 19.10.1993

STATUT

I SHOQËRISË TREGTARE PRIVATE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR TEKNOTRADE LTD.

Në mbështetje të Ligjit 7638 dt. 19. 11. 1992, sot në Tiranë, me dt. 19. 10. 1993, ortakët :

1. Gianfranco LIUZZI - i biri i Oronzos, lindur në Locorotondo (BARI) me 6. 4. 1947 me banim në Bari në Viale della Repubblica, 71/G, me passaport n. 804081, dhe
 2. Angela CAMPANELLA - e bija e Cataldos, lindur në Locorotondo (BARI) me 21. 5. 1948 banuese në Bari në Viale della Repubblica, 71/G, me passaport n. 804082
- me dëshirë dhe vullnet të përbashkët, duke vepruar si themelues të shoqërisë së përbashkët "TEKNOTRADE LTD." (Sh.p.k.), me seli në Rrugën Muhamet Gjollështa - Tiranë, formulojmë këtë statut :

Neni 1

Shoqëria që krijohet është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar që emërtohet shoqëri tregtare private "TEKNOTRADE LTD." (Sh.p.k).

KOHËZGJATJA

Neni 2

Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të veprimtarisë së saj ekonomike mbi 10 vjet.

KAPITALI THEMELTAR

Neni 3

Shoqëria në krijimin e saj ka një kapital themeltar në shumën 50.000.000 Lireta që përbëhet nga derdhjet në masën 60 % nga ortakë Gianfranco LIUZZI dhe në masën 40 % nga ortakë Angela CAMPANELLA.

SELIA E SHOQËRISË

Neni 4

Shoqëria e ka selinë e saj në Tiranë, fillimisht në adresën Rruga Muhamet Gjollështa, Shtëpia Botuese Enciklopedike, kati II - të.

Shoqëria mund të hapë degë të saj me vendqendime të dyta , operative, filiale, përfaqësi dhe agjenci në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe me miratim të organeve kompetente dhe jashtë saj.

Selitë që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë i nënshtrohen Legjislacionit Shqiptar.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 5

1. Në fushën e prodhimit dhe tregtimit me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm të import eksportit si ushqimore, artikuj industrialë, konfeksione kinkalerira, pajisje elektroshtëpiake dhe elektronike, materiale mjeksore, dentare, filma, kaseta audio, video, materiale ndërtimi, makineri e pajisje të ndryshme të import - eksportit.

2. Në fushën e shtypit dhe të botimeve të ndryshme si dhe të tregtimit të tyre.


3. Në fushën e hotelerisë, agjenci turizmi, spedicion, ndërmjetësi, dhe agjenci doganore etj.

4. Në fushën e transportit të pasagjerëve dhe mallrave brenda dhe jashtë vendit.

5. Në fushën e projektimit, realizimit dhe drejtimit të impianteve radiofonikë e televizivë.

6. Në fushën e ndërtimeve qytetare e industriale.

7. Në fushën e operacioneve financiare kombëtare e ndërkombëtare.



ORGANET DREJTUESE

Neni 6

Organet drejtuese të shoqërisë tregtare do të jenë:

1. Asambleja e ortakëve,
2. Presidenti administrator i shoqërisë.

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e punës të organeve drejtuese do të rregullohen me statut.

ASAMBLEJA

Neni 7

Asambleja e shoqërisë tregtare "TEKNOTRADE LTD." do të përbëhet nga dy ortakë themelues. Presidenti i saj do të jetë Gianfranco LIUZZI.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 8

Shoqëria tregtare private "TEKNOTRADE LTD." deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky statut dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

Shoqëria fiton zotësinë e saj për të vepruar në regjistrin e saj në Gjykatën e Rrethit Tiranë dhe ushtron veprimtarinë e saj ekonomike me regjistrimin në organin përkatës tatimor.

Neni 9

Shoqëria ka vulën e saj e cila është drejtkëndëshe me përmasa 35x10 mm, ku është i vendosur emri i firmës me kapitale.

Neni 10

Presidenti i firmës dhe Administratori i autorizuar prej tij janë të veshur me të gjithëfuqinë për drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë brenda rasteve të përcaktuara në këtë Statut dhe në legjislacionin përkatës.

Neni 11

Presidenti i shoqërisë cakton dhe shkarkon Administratorët, të cilëve me aktin e emërimit i cakton detyrat dhe pagën. Po kështu vepron edhe për punëtorët e punësuar.

Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat e punësimit në Republikën e Shqipërisë dhe Sigurimet Shoqërore, ndërsa të gjithë të punësuarit janë të detyruar të pranojnë dhe të zbatojnë këtë Statut dhe aktet përkatëse ligjore të Shtetit.


MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 12

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për çështjet që nuk përfshihen në kontratën e punës zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

Mosmarrëveshjet e punonjësve me shoqërinë kur nuk arrijnë të zgjidhen me marrëveshje do të zgjidhen nga gjykata shqiptare.

Punonjësit e emëruar nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit të realizuar nga shoqëria gjatë ushtrimit të



veprimtarisë së saj, nëse në kontratën e punës nuk parashikohet ndryshe, gjithashtu nuk marrin pjesë në përballimin e humbjeve të saj.

Për punën e kryer punonjësit marrin pagën siç është parashikuar në kontratën e punës.



BILANCI DHE TË ARDHURAT

Neni 13

Veprimet ekonomike dhe financiare të shoqërisë do të mbyllen më 31 Dhjetor të çdo viti, përveç urdhërave të veçanta të Asamblesë.

Në fund të çdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabël i cili miratohet nga Presidenti dhe Asambleja. Në miratimin e bilancit Asambleja vendos për krijimin e fondeve të ndryshme të nevojshme, si fondi i akumulimit, fondi rezervë etj.

Neni 14

Të ardhurat neto, pas veçimit të fondeve të përmendur më sipër dhe pagimit të detyrimit fiskal, i mbesin në përdorim ortakëve të shoqërisë.

Fitimi i realizuar nga shoqëria private do të ndahet në mes të ortakëve të saj në rraport me përqindjen e kapitalit të investuar.

Disponimi i fitimeve, transferimi, zmadhimi i kapitalit themeltar etj., do të bëhen sipas vendimit të themeluesve dhe legjislacionit në fuqi. Çdo transferim i pjesëve të kapitalit themeltar evidentohet me shkrim/

SHPËRBËRJA E SHOQËRISË

Neni 15

Shpërbërja e shoqërisë mund të bëhet në rast falimentimi, privimi të të drejtës për të ushtruar profesionin tregtar, në rast paaftësie që prek njërin prej ortakëve, vdekjeje të ortakut, kur ortakët vendosin me unanimitet për mosvazhdueshmërinë e saj si edhe në të gjitha rastet e tjera të përcaktuara me ligj.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 16

Shoqëria "TEKNOTRADE LTD." për ushtrimin e aktivitetit të saj ka numrin e saj të llogarisë likujduese pranë bankës shqiptare, llogari kjo në valutë të huaj me nr. 1419/207 (Banka Kombëtare Tregtare) 774/3720 (Banka e Kursimeve) dhe lekë shqiptare me nr. 1405/119 (Banka Kombëtare Tregtare), 774/3620 (Banka e Kursimeve).

Neni 17

Të drejtën e nënshkrimit në emër të shoqërisë "TEKNOTRADE LTD." e ka vetëm Presidenti i saj dhe të gjithë personat e autorizuar prej tij me autorizim të posaçëm.

Neni 18

Secili nga ortakët ka të drejtë dhe detyrë të kërkojë dhe të informojë reciprokisht ortakun tjetër për veprimtarinë e tij në kuadrin e firmës në çdo kohë.

Neni 19

Në rast falimentimi ortakët përgjigjen ndaj të tretëve tej fondit të themelimit dhe pasurisë së shoqërisë edhe me pasurinë vetjake në raportin 60 % Gianfranco LIUZZI dhe 40 % Angela CAMPANELLA.

Neni 20

Për dëmtimet e shkaktuara për faj individual, personi fajtor përgjigjet me të ardhurat e veta për çdëmtimin e interesave të shqiptarëve.

Neni 21

Ndryshime të këtij statut mund të bëhen me miratim të themeluesve.

Neni 22

Ky statut përpilohet në disa kopje për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin e shoqërisë tregtare private "TEKNOTRADE LTD." (Sh.p.k) e nënshkruar në të gjitha fletët e saj nga të dy ortakët.

ORTAK

Angela CAMPANELLA

Angela Campanella

Tiranë, me 19.10.1993

PRESIDENTI

Gianfranco LIUZZI

Gianfranco Liuzzi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
N O T E R I A

Nr. 33672 Rep.
Nr. 10756 Kol.

VERTETIM

Vertetohet se sot me dt 28.10.1993, para meje Mimosa Sadushi shi notefe ne kete rreth, u paraqiten personalisht: GIANFRANCO LIUZZI dhe ANGELA CAMPANELLA, madhore dhe me sotesi te plote juridike per te vepruar, te panjohur prej meje, per identitetin e te cileve u sigurova nga leternjofitet e tyre personale me numer 804081 dhe 804082 te cilet kane bere nje statut te nje shoqerie te perbashket tregtare, te hartuar sipas vullnetit te tyre te lire dhe te plote, te cilen e kane nenshkruar rregullisht, si dhe une noteria e vertetoj konform dispozitave ligjore ne fuqi.

